

## KONTRATE DHURIMI

### KUOTA/PJESE

Sot me datën 09.10. 2022 (dymijë e njëzet e dy), u lidh kjo Kontratë Dhurimi (në vijim referuar si "Kontrata"), ndërmjet palëve si vijon:

**DHURUESI:** **Realdo MANSAKU**, shtetas shqiptar, ortak i vetëm i shoqërisë "ENTERPRISES ALBANIA" sh.p.k, lindur me 31.03.1987, ne Tirane mbajtës i letërnjoftimit me nr. 033575520 dhe nr. personal I703310600, me adrese Rr "Sami Frasheri", Nd. 19, H. 8, Tirane dhe tel 0692099911 (në vijim referuar si "Dhuruesi")

**PRANUESI I DHURIMIT:** **Blerina GJATA**, shtetase shqiptare, lindur me 19.01.1984, ne Fier, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. 036204660 dhe nr. personal I45119192H, me adrese V. Bishonok Fier. dhe tel 0698129314. (në vijim referuar si "Pranuesi i Dhurimit")

Këtu e në vijim Dhuruesi dhe Pranuesi i Dhurimit do të referohen individualisht si "Palë" dhe së bashku si "Palët".

### **PARASHTRIMET:**

- Shoqëria "ENTERPRISES ALBANIA" Sh.p.k., shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, themeluar sipas legjislacionit shqiptar, regjistruar pranë regjistrat tregtar të mbajtur pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (në vijim referuar si "QKB") me Numër Unik Identifikimi të Subjektit (NUIS): L51902031P, dhe seli në adresën *Njësia Bashkiake Nr. 5, Rruga Andon Zako Çajupi, Ndërtesa Nr. 3, Hyrja 11* (në vijim referuar si "Shoqëria")
- Bazuar ne Ekstraktin e Shoqërisë, kapitali i saj është 1.000,00 (një mijë) Lekë i ndarë si vijon:
  - Realdo Mansaku, zotërues i 1 (një) kuote/pjese, me vlerë nominale 1.000,00 (një mijë) Lekë, që i korrespondojnë 100 (njëqind) % të kapitalit të Shoqërisë;
- Dhuruesi siç përshkruhet edhe me sipër, është ortak i vetëm i Shoqërisë dhe zotërues i 1 (një) kuote/pjese, me vlerë nominale 1.000,00 (një mijë) Lekë, që i korrespondojnë 100 (njëqind) % të kapitalit të Shoqërisë.
- Dhuruesi dhe njëherazi Ortaku i Shoqërisë, dëshiron të tjetërsojë 20% te kuotës/pjesës që ai zotëron në Shoqëri, nëpërmjet dhurimit tek Pranuesi i Dhurimit.
- Pranuesi i Dhurimit nga ana tjetër pranon dhurimin e bërë nga Dhuruesi dhe shprehet se dëshiron të bëhet pronar i 20% te kuotës/pjesës që Dhuruesi zotëron tek Shoqëria.
- Organet kompetente të Shoqërisë, të Dhuruesit dhe të Pranuesit të Dhurimit kanë miratuar të gjitha vendimet e nevojshme për miratimin e këtij transaksioni për kuotën.

**PËR KËTË ARSYE**, në përputhje me sa më sipër, Palët bien dakord që të lidhin këtë Kontratë, sipas kushteve dhe afateve të mëposhtme:

## NENI 1 PARASHTRIMET, SHTOJCAT DHE INTERPRETIMI

### 1.1 Parashtrimet /Shtojcat

Parashtrimet dhe dokumentet bashkëngjitur janë pjesë përbërëse e kësaj Kontrate dhe do të interpretohen sipas kuptimit të këtij neni.

### 1.2 Interpretimi

Përveç se kur konteksti i kësaj Kontrate kërkon ndryshe:

(i) fjalët e secilës gjini do të përfshijnë edhe gjininë tjetër;

(ii) termat "*të kësaj*", "*këtu*", "*nëpërmjet kësaj ose nga kjo*", "*në këtë*" dhe fjalë të ngjashme i referohen Kontratës në tërësi dhe jo ndonjë Neni, Paragrafi, Bashkëlidhje apo ndonjë nënndarje tjetër të kësaj Kontrate;

(iii) Parashtrimet, Shtojcat, dhe Bashkëlidhjet e kësaj Kontrate do të përbëjnë pjesë integrale të saj dhe referencat në Shtojcat dhe Bashkëlidhjet do të jenë referenca në Shtojcat dhe Bashkëlidhjet e kësaj Kontrate, përveç kur Palët merren vesh ndryshe.

(iv) referencat në ndonjë akt përfshijnë çdo ndryshim ose ri-nxjerrjeje të atij akti, si dhe çdo rregull ose rregullore të nxjerrë në zbatim të këtij akti; dhe referenca në një ligj do të thotë referencë në një ligj të tillë, siç mund të jetë ndryshuar, rinxjerrë apo ribërë;



(v) fjalët "*përfshin*" ose "*duke përfshirë*" do të konsiderohet se pasohen nga "*pa kufizim*" ose "*duke mos u kufizuar në*", edhe nëse ato ndiqen ose jo nga fraza ose fjalë të tilla të ngjashme;

(vi) referencat në "*kjo kontratë*" ose në çdo marrëveshje ose dokument tjetër do të interpretohen si referenca në këtë kontratë ose dokument, të ndryshuar, modifikuar, ose shtuar dhe që janë në fuqi nga koha në kohë, si dhe do të përfshijnë referencën në çdo dokument që e ndryshon, modifikon ose e shton atë dokument, ose që është lidhur, bërë ose dhënë në zbatim ose në përputhje me kushtet e saj;

(vii) sa herë që kjo Kontratë i referohet një numri "*ditësh*" ky numër do t'i referohet ditëve kalendarike, përveç kur shprehimisht specifikohen si Ditë Pune;

(viii) titujt e Neneve, Kapitujt dhe Nenet në këtë Kontratë janë bërë vetëm për qëllime lehtësimi dhe reference, dhe këto nuk do të ndikojnë në asnjë mënyrë në interpretimin e kësaj Kontrate.

## NENI 2 OBJEKTI I KONTRATES



- 2.1 Objekt i kësaj Kontrate është transferimi me anë të dhurimit tek pranuesja e dhurimit, të 1 (një) pjese, me vlere nominale 200 (dyqind) leke, qe i korrespondojnë 20 (njëzet)% të kapitalit të shoqërisë.
- 2.2 Ortaku, Realdo MANSAKU, mbetet pronar i 1 (një) pjese, me vlere nominale 800 (tetëqind) leke, qe i korrespondojnë 80 (tetëdhjetë)% të kapitalit të shoqërisë.

### NENI 3 DEKLARIMET DHE GARANCITË

#### 3.1 Deklarimet dhe Garancitë e Dhuruesit

##### *(a) Pronar i Ligjshëm*

Dhuruesi deklaron dhe garanton se është pronari i ligjshëm i kuotës se zotëruar prej tij në Shoqëri dhe nuk ka asnjë pengesë ligjore, dhe/ose nuk i nevojitet asnjë tagër tjetër ligjor për të lidhur këtë kontratë, dhe për të përmbushur detyrimet që rrjedhin prej saj.

##### *(b) Barrët mbi Pronën*

Dhuruesi deklaron se kuota e zotëruar prej tij në Shoqëri, objekt i kësaj Kontrate nuk është e ngarkuar me asnjë barrë, qoftë si peng, barrë siguroese apo barrë financiare (qofshin këto ligjore, gjyqësore apo kontraktore), apo të drejta të tjera të ngjashme me to, çdo e drejtë apo interes i dhënë me kontrate çdo personi, duke përfshirë çdo të drejte blerje, opsioni ose të drejtë parablerje, dhënie përdorimi apo posedimi me kontrata të tjera, si dhe pa u kufizuar në to, çdo transaksion, veprim juridik a kufizim ligjor tjetër, përfshi këtu çdo vendim gjyqësor, përfundimtar apo të ndërmjetëm, vendim përmbarimor, apo të autoriteteve të tjera përcaktuar me ligj, i tillë që do të cënonte titullin e pronësisë së Pranuesit të Dhurimit mbi kuotën objekt të transferimit sipas kësaj Kontrate.

##### *(ç) Garancia*

Në bazë të njohurive më të mira të Dhuruesit, në datën e lidhjes së kësaj Kontrate nuk ekzistojnë pretendime nga të tretët, çështje gjyqësore në gjykim, të pezulluara ose të mundshme, pretendime ose vendime gjyqësore a masa sigurimi në lidhje me kuotën objekt transferimi sipas kësaj Kontrate dhe asnjëra prej këtyre padive, proceseve gjyqësore, masave dhe pretendimeve nuk ka të ngjarë të ndodhë; Të gjitha deklaratimet dhe garancitë e Dhuruesit të paraqitura më sipër janë të vërteta dhe të sakta.

#### 3.2 Detyrimet e Dhuruesit

##### *(a) Nënshkrimi i Akteve*

Dhuruesi merr përsipër dhe detyrohet të nënshkruajë çdo akt e të kryejë çdo veprim juridik pa vonesa, kur i kërkohet nga Pranuesi i Dhurimit, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me kuotën objekt transferimi sipas kësaj Kontrate, e që mungesa e të cilit do të pengonte ushtrimin e plotë,

të pakushtëzuar e të pakufizuar prej Pranuesit të Dhurimit të së drejtës së tij të pronësisë mbi këtë kuotë.

*(b) Mbrojtja Gjyqësore*

Në rastin kur një palë e tretë (përfshi autoritetet publike) ngre pretendime dhe/ose bën ankime gjyqësore për të kundërshtuar titullin e pronësisë të Pranuesi i Dhurimit mbi kuotën objekt transferimi sipas kësaj Kontrate, ose duke u bazuar në pretendime të mëparshme cenon apo kundërshton të drejtat që burojnë nga kjo kuotë, Dhuruesi merr përsipër dhe detyrohet të thirret/ndërhyjë në gjykimin e çështjes, dhe me shpenzimet e saj të mbrojtë interesat e Pranuesit të Dhurimit si të ishin të tijat.

*(c) Cënimi i Titullit*

Pa kufizuar të drejtat e tjera të Pranuesit të Dhurimit të përcaktuar me ligj, Dhuruesi merr përsipër dhe detyrohet të mbrojë, zhvendosë, dëmshpërblejë, dhe ruajë Pranuesin e Dhurimit, ndaj dhe në vlerën e plotë të: (i) çdo detyrimi, dëmi, humbjeje, apo shpenzimi, përfshi këtu shpenzimet e avokatit apo të ekspertëve të Dhuruesit që rezultojnë nga dokumente zyrtare (kontrata, fatura), të pasur nga Pranuesi i Dhurimit për t'u mbrojtur nga çdo pretendim, kërkesë, apo padi, proces a vendim gjyqësor, përmbarimor të një të treti (*për qëllimet e këtij neni, i tretë quhen edhe autoritetet publike kur veprojnë në rastet e parashikuara me ligj*) që duke u hequr si pronar i ligjshëm, kundërshton titullin e pronësisë të Pranuesit të Dhurimit mbi kuotën objekt transferimi sipas kësaj Kontrate.

## **NENI 5 TË NDRYSHME**



5.1 Marrëveshja e Plotë

Kjo Kontratë, duke përfshirë Parashtrimet dhe Shtojcat bashkëngjitur saj, përbën tërësinë e marrëveshjes së lidhur ndërmjet Palëve në lidhje me objektin e saj, dhe zëvendëson çdo ose të gjitha kontratat, marrëveshjet e mëparshme apo mirëkuptimet, me gojë ose me shkrim, ndërmjet Palëve në lidhje me pjesët objekt të transferimit sipas kësaj Kontrate. Çdo shtesë apo ndryshim i kësaj Kontrate duhet të kryhet me shkrim dhe të miratohet nga palët përndryshe do të konsiderohet e pavlefshme.

5.2 Veçueshmëria e Kontratës

Nëse ndonjë kusht apo dispozitë e kësaj Kontrate shpallet e pavlefshme dhe/ose e paligjshme dhe/ose e pazbatueshme, dispozitat e tjera të Kontratës, për sa është e mundur nuk do të ndikohen prej kësaj pavlefshmërie. Në këto raste, Palët në mirëkuptim do të mundohen të zëvendësojnë pa vonesa dispozitat e pavlefshme, me dispozita të vlefshme, me qëllim përmbushjen e objektit të kësaj Kontrate.

5.3 Njoftimet




- a Çdo njoftim ose komunikim tjetër nga njëra Palë te Pala tjetër, i cili kërkohet ose lejohet të bëhet sipas dispozitave të kësaj Kontrate do të:
- (i) bëhet në gjuhën shqipe;
  - (ii) bëhet me shkrim;
  - (iii) dërgohet personalisht (dorazi) ose dërgohet me anë të postës së regjistruar me parapagim ose me postë të shpejtë në adresën e Palës tjetër, e cila është paraqitur më poshtë ose në ndonjë adresë tjetër të cilën do ta kërkojë me anë njoftimi Pala tjetër, dhe
  - (iv) shënohet në vëmendje të personit(ave) të përcaktuar më poshtë ose të person(ave) të tjerë të tillë që mund t'i kërkojë me anë njoftimi Pala tjetër.
- b Çdo njoftim ose komunikim tjetër i bërë nga njëra Palë te tjetra, në përputhje me dispozitat e mësipërme të këtij Neni, do të konsiderohet se është marrë nga Pala tjetër nëse është dërguar dorazi në ditën që është lënë në adresën e mëposhtme të palës tjetër (siç mund të ndryshohet herë pas herë me njoftimin e arsyeshëm të kryer nga secila Palë te Pala tjetër), nëse është dërguar me anë të postës së regjistruar me parapagim ose me postë të shpejtë dyzet e tetë orë (48) nga data e postimit, ose nëse është dërguar me faks, siç është parashikuar më sipër, në adresat e deklaruara prej palëve.

## NENI 6 EFEKTE LIGJORE

- 6.1 Palët bien dakord se me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Pranuesi i Dhurimit bëhet pronar me të drejta të plota të kuotës së dhuruar, sipas përcaktimit të Objektivit të kësaj Kontrate, si më sipër, dhe Dhuruesi zhvishet nga çdo e drejtë lidhur me këtë kuotë.
- 6.2 Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, pjesëmarrja në Shoqëri do të jetë si më poshtë:
- **Blerina GJATA**, behet zotëruese e 1 (një) pjese, me vlere nominale 200 (dyqind) leke, qe i korrespondojnë 20 (njëzet)% të kapitalit të shoqërisë.
  - **Realdo MANSAKU**, mbetet ortak i shoqërisë dhe njëkohësisht pronar i 1 (një) pjese, me vlere nominale 800 (tetëqind) leke, qe i korrespondojnë 80 (tetëdhjetë)% të kapitalit të shoqërisë.
- 6.3 Dhuruesi merr përsipër, që do të kryejë të gjitha veprimet përkatëse për të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit ("QKB") këtë Kontrate dhe ndryshimet përkatëse në pjesëmarrjen e kapitalit të Shoqërisë sipas pikës 6.2 të këtij neni të Kontratës.

## NENI 7 ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE



- 7.1 Nëse midis palëve do të lindë ndonjë mosmarrëveshje në lidhje me zbatimin apo interpretimin e kësaj Kontrate (në vijim referuar si "**Mosmarrëveshje**"), secila nga Palët do t'i japë Palës tjetër njoftim me shkrim në lidhje me këtë Mosmarrëveshje, duke parashikuar shkaqet e mosmarrëveshjes. Pas njoftimit Palët do të takohen menjëherë dhe do të përpiqen me mirëbesim të arrijnë një zgjidhje me pajtim në përputhje me legjislacionin shqiptar për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.
- 7.2 Nëse nuk arrihet një zgjidhje me pajtim në përputhje me sa më sipër brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit të parashikuar më sipër, çdo Mosmarrëveshje do të zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Seksioni Civil.

**NENI 8  
DISPOZITAT E FUNDIT**


- 8.1 Kjo Kontratë është hartuar në 3 (tre) dokumente origjinale te barasvlershëm, në gjuhën shqipe.
- 8.2 Kjo Kontratë hyn në fuqi ne datën e nënshkrimit te saj nga të dyja palët.


**DHURUESI**

**PRANUESI I DHURIMIT**

**Realdo MANSAKU**

**Blerina GJATA**

Realdo Mansaku  


Blerina Gjata  


**REZULTATET E KËRKIMIT**

Numri i Rezultatit te Kerkimit: D-2022100417121639  
Data e Rezultatit te Kerkimit: 04.10.2022  
Ora e Rezultatit te Kerkimit: 5:01:21PM  
Lloji i Kerkimit:  
Numri i Dokumentit: D-400-221-5056  
Referenca e Perdoriesit:

**LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI 0**

REALDO PËTRIT MANSAKU  
ENTERPRISES ALBANIA SH.P.K.



*Armando Buser*

VENDIM NR.    PROT.

I ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË ORTAKEVE

TË SHOQËRISË “ENTERPRISES ALBANIA” SH.P.K.

Sot me datë 04 / 10 /2022, ora 10:00 am pranë selisë të Shoqërisë “ENTERPRISES ALBANIA” Sh.p.k., shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, themeluar sipas legjislacionit shqiptar, regjistruar pranë regjistrat tregtar të mbajtur pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (në vijim referuar si “QKB”) me Numër Unik Identifikimi të Subjektit (NUIS): L51902031P, u mbajt mbledhja e Asamblesë me praninë e Ortakut të vetëm

- **Realdo MANSAKU**, zotërues i 1 (një) kuote/pjese, me pjesëmarrje 100 (njëqind)% në kapitalin e shoqërisë “ENTERPRISES ALBANIA” sh.p.k.;

me rend dite si më poshtë vijon:

1. Miratimin e Kontratës së Dhurimit të Kuotës/Pjesës të lidhur me datë 04 / 10 / 2022, të midis ortakut të vetëm, **Z. Realdo MANSAKU** dhe **Znj. Blerina Gjata**, me objekt dhurimin e një pjese, me vlerë nominale 200 (dyqind) leke, që i korrespondon 20% të kapitalit të shoqërisë, nga kuota/pjesa që ortaku zotëron në Shoqërinë “ENTERPRISES ALBANIA” sh.p.k.

Në lidhje me këtë çështje asambleja e shoqërisë “ENTERPRISES ALBANIA” sh.p.k:

**VENDOSI**

1. Miratimin e Kontratës së Dhurimit të Kuotës/Pjesës të lidhur me datë 04 / 10 / 2022, të midis ortakut të vetëm, **Z. Realdo MANSAKU** dhe **Znj. Blerina Gjata**, me objekt dhurimin e një pjese, me vlerë nominale 200 (dyqind) leke, që i korrespondon 20% të kapitalit të shoqërisë, nga kuota/pjesa që ortaku zotëron në Shoqërinë “ENTERPRISES ALBANIA” sh.p.k.
2. Ngarkohen Administratorët që personalisht apo nëpërmjet personave të tretë të autorizuar prej tyre, të depozitojnë këtë Vendim pranë QKB-së.

**ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË**

Realdo MANSAKU







REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

## EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”

### GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	L51902031P
2. Data e Regjistrimit	02/07/2015
3. Emri i Subjektit	ENTERPRISES ALBANIA
4. Forma ligjore	SHPK
5. Data e themelimit	19/06/2015
6. Kohëzgjatja	Nga: 19/06/2015
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane TIRANE Njesia Bashkiake Nr. 5, Rruga Andon Zako Çajupi, Ndertesa Nr. 3, Hyrja 11
8. Kapitali	1.000,00
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	1,00
9. Objekti i aktivitetit	Trajtimin e mbetjeve te ndryshme industriale perfshire mbetjet nga industria e naftes dhe rafinerit, trajtimin e vajrave te perdoruara , mbledhjen e vajrave te mbetjeve si dhe pastrimin e mbetjeve nga anijet. Trajtimin e mbetjeve te gjeneruara nga industrite e tjera si: industria plastike , industria e gomes , baterite , te gjitha llojet e mbetjeve te riciklueshme dhe te rikuperueshme ,mbetjet e industrise mekanike , te industrise se letres ,te industrise se prodhimit te kimikateve ,te industrise se plehrave kimike , te industrise se prodhimit te bojrave te vajit ,mbetjeve te pesticideve , te mbetjeve te industrise perpunuese te ushqimeve per blegtorine ,te industrise ushqimore , trajtimin e mbejteve te biodegradueshme. Trajtimin e ujrave te kontaminuara nga industrite e ndryshme , perfshire ujrat e kontaminuara nga hidrokarburet, nga rafinerit , nga ujrat e zeza dhe nga te gjitha industrite e tjera kimike dhe ushqimore. Trajtimin e dherave te ndotura nga industrite e ndryshme kimike , pesticide, industrite e naftes , prodhimit te kimikateve dhe cdo lloj ndotje tjeter e dherave. Grumbullimin dhe



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

transportin e te gjitha llojeve te mbetjeve pa perjashtim. Aktivitet ne promovimin dhe zhvillimin e pasurive te paluajtshme ne sektorin turistik-rezidencial, operacione tregtare, industriale, financiare, mobiliare dhe imobiliare, agjensi i vleresimi mjedisor. Import eksport tregtim me shumice dhe pakice te mallrave te ndryshme industriale, ushqimore artikuj bujqesore dhe blektorale, paisje elektronike, elektrike, informatike, elektroshtepiake, konfeksione, metrazhe, lende kimike, detergjente pastrues, produkte kozmetike. Projektim, ndertim te oibjekteve sociale kulturore, ekonomike, industriale, objekte banimi. çertifikim i eneve nen presion. çertifikim i paisjeve elektrike. Prodhmi dhe tregtim materiale ndertimi. Prodhim inertesh, prodhim dhe tregtim te artikujve te ndryshem mobilerie, dyer dritare, artikuj duralumini, tregtim paisje zyre, kancelari, paisje ventilimi dhe kondicionimi. Tregtim paisje hidraulike, paisje hidrosanitare dhe aksesore te tyre. Tregtim me pakice te karburanteve, dhe vajrave lubrifikante , hoteleri , turizem, bar restaurant. Agjensi udhetimesh turistrrike, agjensi shitje biletash te transportit urban, hekurudhor, ajror, dhe detar etj. Import eksport dhe tregtim me shumice dhe pakice te automjeteve te llojeve dhe tonazheve te ndryshme dhe pjeseve te kembimit per to. Shitblerje automjetesh, ekspozim dhe shitja e tyre dhe nepermjet ankandit. Servis automjetesh. Dhe agjensi shitblerje automjetesh. Konsuletnce mjedisore dhe ne fusha te tjera. Eksplorim, kerkim dhe shfrytezim i lendeve minerare , Konsultim dhe menaxhim i veprimtarise minerare , ne fushen e shfrytezimit te pasurive nentoksore dhe mbitokesore Prodhim , shitje - blerje , transport te kromit , hekur nikelit dhe pasurive te tjera minerare, magazinimin dhe perdorimin e lendeve plasese. 1. Projektim, ndertimi, mbikeqyrje, kolaudim i impianteve te prodhimit te energjise dhe prodhimi saj nga uji, dielli (fotovoltaik), burimet termike, burim gjeotermale, era, biogazi, nafta dhe qymyri, per vete ose per te tretet. 2. Ndertimi i impianteve per prodhimin e energjise elektrike. Centrale termike (primare, sekondare). Impiante te prodhimit dhe shperndarjes se energjise elektrike, diellore, era etj. 3. Importimi dhe prodhimi i pajisjeve teknike ne fushen e teknologjise se permendur ketu duke perfshire cogjeneratoret dhe teknologji te tjera per te



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

	prodhuar energji. 4. Prodhim i energjise se rinovueshme (dielli, era, uji, biomass etj) dhe jo-te rinovueshme ne Shqiperi dhe shitjen e energjise se prodhuar sipas formave te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi. 5. Keshillim te pa/eve te treta ne fushat e permendura, krijimin e studimeve te fizibilitetit dhe planeve te biznesit. 6. Analiza dhe vleresim te biznesit, keshillime mbi transaksionet e shitjeve/dhe analiza per strategjine e shitjeve, keshillime mbi partnership-e te ndryshme dhe negocime te termave te marreveshjes, keshillime mbi vleresimin e aseteteve te Shoqerive dhe kapitalit njerezore, asistime ne pergatitjen e raporteve vjetore, vleresime risku dhe keshillime per mitigimin e tyre. Ristrukturime te bizneseve ne veshtiresi, keshillime dhe asistencë ne marredheniet me institucionet financiare, keshillime dhe bashkepunime me dhe per sektorin publik. 7. Vleresim te pasurive te paluajtshme, per ndertesat e toke truall; toke bujqesore; toke pyjore; kullote; livadh dhe toke te pcfrytshme; linja teknologjike, makineri e pajisje	
10. Administratori/ët	Realdo Mansaku	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 19/06/2020	Deri: 19/06/2025
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Ortakët	RealdoMansaku	
12.1 Vlera e kapitalit	Para: 1.000,00	Natyre:
12.2 Numri i pjesëve	1,00	
12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	100,00	
<i>*Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse një kuotë zotërohet në bashkëpronësi)</i>		
12.4 Komente (nëse ka)		
13. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit		
14. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: ENTERPRISES ALBANIA Telefon: 0692099911	
15. Statusi:	Aktiv	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

Datë: 06/10/2022

\_\_\_\_\_  
Emri, Mbiemri, Nënshkrimi  
(i nëpunësit të sportelit)



*Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë  
të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra Kombëtare e Biznesit)*